REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 843/20
Datë/Datum. 22.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Autoritetit Kontrakutes – Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit: IL-20-4215-1-2-1
Numri i brendshëm: IL-20-019-121

Sa i përket tenderit për: "Furnizimi dhe instalimi i softwerit sistemi ERP - RITENDER"

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

PBC Sh.P.K., Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

Adresa: Rruga Idriz Gjilani p.n.

Vendi: Prishtinë **Kodi postar:**10000

Numri i telefonit: 044 467 467 **Numri i faksit:**

Emri i përfaqësuesit: Bashkim Selmani

E-mail: bashkim@pbc-ks.com

Datë: 22 tetor 2020 *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit: Granit Vokshi, avokat

Adresa: Rruga Robert Doll, Nr.34, 10000 Prishtinë

Numri i telefonit: 044 352 345
e-mail: vokshi@kocivokshi.com

Avokat - Attorney at Law
Granit Vokshi
Tel: 044 352 345
vokshi@kocivokshi.com

Data: 22 tetor 2020 Nënshkrimi dhe vula:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **Më 06.08.2020**, është përgatitur dosja e tenderit lidhur me ftesën për tender për "Furnizimi dhe instalimi i softwerit sistemi ERP - RITENDER";
- OE PBC Sh.P.K., kishte ofertuar me çmim **EUR** 34,750.00 (**me fjalë:** tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë Euro pikë zero cent);
- **Më 22 shtator 2020**, OE PBC, kishte ofruar sqarimet e nevojshme, lidhur me partneritetin me Microsoft si brand botëror, duke bashkëngjitur Autorizimin si dhe Kontratën e partneritetit;
- **Më 5 tetor 2020**, AK – nxjerr Njoftim për anulimin e Aktivitetit të Prokurimit;
- **Më 9 tetor 2020**, OE PBC, parashtron Kërkesë për Rishqyrtim;
- **Më 13 tetor 2020** – AK nxjerr Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☑ **Jo** ☐

NA

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☑ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/ Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

OE PBC Sh.P.K., në cilësinë e palës së interesuar, parashtron se Autoriteti Kontraktues, gjatë vendosjes lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE PBC ndaj vendimit për anulimin e tenderit, të njejtin e ka zhvilluar në shkelje të:

Nenit 62 të LPP-së; dhe
Nenit 43 dhe 44 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Hyrje

- AK – në Njoftimin e datës 5 tetor 2020, lidhur me Vendimin për Anulimin e aktivitetit të prokurimit, njofton lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit për arsye se asnjë tender i përgjegjshëm nuk është pranuar për këtë projekt.

- Lidhur me këtë Njoftim, OE PBC, më 9 tetor 2020, kishte parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, kështu në mënyrë të qartë duke bërë të besueshëm faktin se Njoftimi lidhur me anulimin e tenderit, ishte bërë në shkelje të dispozitave të LPP-së dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

- Megjithatë, në Vendimin e datës 13 tetor 2020, në Arsyetimin e të njejtit, përkatësisht në Sqarimet e dhëna lidhur me këtë vendim, parashtron:

  1. "OE PBC ka ofruar një autorizim nga Microsoft i cili nuk e mbulon projektin apo brand-in për softwerin e ofruar ERP duke qenë se ky autorizim nga Microsoft është i vjetër dhe është i lëshuar për një projekt tjetër (autorizimi është lëshuar në vitin 2018 për projektin e Ministrisë së Financave)."

- Më tutje, AK, parashtron:

  2. "Për më tepër OE PBC deklaron se do ta sjell autorizimin nga Microsoft nëse oferta e tyre zgjidhet, me çka dëshmohet se një autorizim i tillë nuk ka ekzistuar në momentin e dorëzimit të ofertës."

- Dhe në fund, AK – parashtron:

  3. "Sipas Ligjit për Prokurim Publik, neni 72 pika 3 „Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive." Edhe në RROUP, në nenin 39 pika 39.3 është përcaktuar si në vijim: „ Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzsituese para datës së publikimit te Njoftimit për kontratë." Prandaj, duke qenë se një autorizim i tillë nuk ka ekzistuar në momentin para ofertimit, NH Ibër Lepenc nuk ka patur të drejtë që një autorizim të tillë ta kërkoj sepse do të bëhej ndryshim material në ofertën e dorëzuar."

- Para se të lëshohemi në përmbajtjen e arsyetimit të dhënë nga AK në Vendimin refuzues, OE PBC parashtron se AK dështon që të ofrojë përgjigje në argumentimin kryesor të ngritur në Kërkesën për rishqyrtim, lidhur me Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.

- Për hir të argumentimit dhe sqarimit të pozicionit të OE PBC, lidhur me pabazueshmërinë e anulimit të aktivitetit të prokurimit edhe njëherë do të ritheksojë se pse, ky anulim ishte bërë në kundërshtim me LPP-në dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, përkatësisht Nenit 62 të LPP-së si dhe, neneve 43 dhe 44 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, që flasin lidhur me kushtet që duhet plotësuar për anulimin e një aktiviteti të prokurimit. Sipas OE PBC, asnjëri nga kushtet të cilat do t'i elaborojmë më poshtë, nuk janë plotësuar.

Arsyetim

- Neni 62 i LPP-së, lidhur me përfundimin e aktivitetit të prokurimit, parashtron se AK mund ta përfundojë një Aktivitet të prokurimit vetëm për njërën nga arsyet:

- një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;

- të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

- para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontaktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

- Andaj – nga arsyetimi i Njoftimit të AK-së, **nuk del se përmbushen ndonjëra nga arsyet e parapara në Nenin 62 të LPP-së**. Nga arsyetimi i AK-së nuk del se është shkelur ndonjë ligj aktual apo se mund të ndodhë në një procedurë të prokurimit; tenderët nuk përmbajnë çmime që tejkalojnë buxhetin e AK-së, si dhe, çfarëdo ngjarje objektive që ka rrjedhë më pastaj – nuk ka qenë e paparashikueshme, për shkak se nuk kemi të bëjmë me ngjarje të *vis majoris* të paparashikueshme, kur ato dihen botërisht se çfarë rrethana mund të jenë, e që në rastin konkret nuk janë prezent.

- Neni 44, në paragrafin 7 dhe 8 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik parasheh rastet kur duhet dhe kur mundet të anulohet procedura e prokurimit.

  Pika 7 e Nenit 44, parashtron se pas marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet:
  - Asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të parashikuar;
  - Asnjëri prej tenderëve nuk është i përgjegjshëm;
  - Numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE – është më pak se 3;
  - Nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara konkurruese në negociata më pak se 3;
  - Nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
  - Asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
  - Nëse urdhërohet nga organi shqyrtues i prokurimit; ose
  - Një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshim.

  Pika 8 e Nenit 44, parashtron se pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen:

- Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së.

- Megjithëse AK, në arsyetimin e vendimit thekson se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet për arsye se asnjëri prej tenderëve nuk është i përgjegjshëm, AK dështon të argumentojë se pse një arsyetim i tillë aplikon pikërisht tek OE PBC. AK në arsyetimin e saj për refuzimin e ofertës së OE PBC, thirret në atë se ky i fundit nuk ka ofruar autorizim për brendin siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

- **Në vijim të kësaj Ankese, do të trajtojmë Përgjigjen, përkatësisht sqarimin e AK ndaj Kërkesës për Rishqyrtim**

- **Lidhur me pretendimin** i cili parashtron se OE PBC ka ofruar një autorizim i cili është i vjetër dhe është i lëshuar për një projekt tjetër, OE PBC thekson faktin se në dosjen e tenderit, përkatësisht në pikën 9.1 dhe 9.2 (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale), qartazi kuptohet se në rast të ofertimit të softuerëve botërore, Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar dhe **të ketë partneritet me kompaninë - brandin**.

  Pra – kërkohet që të dëshmojë partnerinet – dhe këtë e ka dëshmuar me anë të Marrëveshjes me kompaninë Microsoft si dhe ka bashkangjitur një Autorizim, si dëshmi se bashkëpunimi ka ekzistuar në të kaluarën dhe një i tillë ekziston edhe më tutje.

  Kësisoj - OE PBC, një partneritet të tillë e ka dëshmuar me deklaratën e datës **22 shtator 2020** ku kishte dorëzuar Marrëveshjen me kompaninë Microsoft dhe ka shprehur gatishmërinë që për çdo sqarim shtesë që nevojitet nga AK, të njejtës t'i ofrojë të gjithë dokumentacionin përkatës. Vlen të theksohet se një autorizim i veçantë për një periudhë të caktuar kohore – nuk kërkohet shprehimisht në Dosje të Tenderit, andaj përgjigja / sqarimet e AK – përbëjnë tejkalim të kërkesave që dalin nga Dosja e Tenderit.

- Theksojmë, se dispozita e lartcekur qëndron e heshtur sa i përket faktit se ekzistimi i partneritetit është valid vetëm për projektin aktual. Këtu shprehet qartë, tendenca e AK për të interpretuar gjerësisht këtë dispozitë – ashtu që të realizojë qëllimin e saj për anulimin e aktivitetit të prokurimit pa ndonjë arsye valide, përkatësisht Refuzojë kërkesën për Rishqyrtim.

OE PBC, në plotëni kishte plotësuar kërkesat që dalin nga Dosja e tenderit, kështu duke dorëzuar:

- Marrëveshje me prodhuesin siç edhe është kërkuar në dosje të tenderit;

- Certifikimet nga Microsoft me ERP - listën e stafit kyç profesional të certifikuar adekuate nga Prodhuesi;

- Deklaratën me anë të së cilës e kishte njoftuar AK-në se është në gjendje që, në çdo kohë të sigurojë dokumente tjera shtesë, sipas kërkesës – përfshirë edhe autorizim të veçantë për këtë akitivitet të prokurimit, në çdo kohë që AK do e konsideronte të nevojshëm dhe ta kërkonte nga OE PBC. Mirëpo – një autorizim i veçantë, për këtë aktivitet të prokurimit, nuk është kërkuar nga AK në kërkesat që dalin nga dosja e tenderit, por vetëm është kërkuar të dëshmohet partneriteti me Microsoft.

- **Lidhur me pikën** ku AK pretendon se: "[...] *duke qenë se një autorizim i tillë nuk ka ekzistuar në momentin para ofertimit, NH Ibër Lepenc nuk ka patur të drejtë që një autorizim të tillë ta kërkoj*

sepse do të bëhej ndryshim material në ofertën e dorëzuar [...]," edhe kjo Përgjigje / Sqarim i AK-së ndaj Kërkesës për Rishqyrtim nuk qëndron, sepse me këtë rast, nuk do kishim asnjë lloj ndryshimi material të ofertës së dorëzuar siç pretendon AK. Kjo sepse, Dosja e Tenderit në pikën 9.1 & 9.2. – në mënyrë shprehimore kërkon që:

"Ne rast te ofertimit te softuereve boterore, Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar dhe te kete partneritet me kompanine - brandin"

Pra – partneriteti me kompaninë – brandin siç u tha më lartë, veçse është dëshmuar dhe një autorizim i veçantë për këtë projekt, nuk është kërkuar në asnjë pjesë të dosjes së tenderit.

Përfundimisht - OE PBC parashtron se AK – lidhur me pretendimin se do duhej bashkangjitur një autorizim i veç për këtë Aktivitet të Prokurimit, përbën ndërrim / shtim kriteresh gjatë vlerësimit, përkatësisht gjatë vendosjes lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim.

- Pra – nuk qëndron arsyetimi i Vendimit mbi Refuzimin për Rishqyrtim të Njoftimit të AK, se gjithë Operatorët Ekonomikë, përfshirë OE PBC – janë të papërgjegjshëm, sepse nga argumentimi i mësipërm, del se i njejti është i përgjegjshëm për shkak se secilën pikërisht atë kërkesë të FTD-së e plotëson dhe si të tillë, do të mund ta argumentonte, në rast se AK do të kërkonte sqarime shtesë, e të cilat sqarime mund t'i kërkonte në çdo kohë, në mbështetje të dispozitave të LPP-së, përkatësisht Nenit 72 i cili parashtron:

"*Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.*"

Nenit 39 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, i cili në paragrafin 3 parashtron:

"*Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/ tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë se kane ekzistuar para afatit te fundit te dorëzimit te aplikacionit apo te dorëzimit të tenderit. Përveç kësaj, kërkesa nuk do te duhej qe të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës.*"

Si dhe paragrafit 8 të Nenit 39 të RrUOP, i cili parashtron:

"*Në qoftë se oferta dorëzohet në mënyrë elektronike, AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik në Kosovë, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik.*"

- Përfundimisht – nga leximi i kushteve që duhet plotësuar në rastet kur duhet dhe mund të Anulohet procedura e prokurimit nga AK – del se asnjëra nga arsyet e sipërcituara nuk aplikojnë në rastin konkret dhe në shkaqet për të cilat është anuluar kjo procedurë e prokurimit – përkatësisht është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, mirëpo e njejta ka ardhë si rezultat i arsyeve tërësisht të paligjshme dhe periferike për të cilat OE PBC nuk ka ndonjë interes të jetë në dijeni se çfarë aktivitete të tjera janë në zhvillim e sipër. Po ashtu – me këtë rast, qartazi u dëshmua se nuk janë ndëmarrë gjitha veprimet e nevojshme nga AK në kuptim të sqarimit të aplikacionit dhe përmbushjes së kërkesave që dalin nga Dosja e Tenderit nga OE PBC Sh.P.K.

- Andaj – me këtë rast, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që këtë Ankesë ta **Aprovojë** si të bazuar dhe këtë lëndë ta kthej në **Rivlerësim.**

Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e lartcekura e të evidentuara qartë, padyshim se ka çuar edhe në dëme materiale, për shkak se OE PBC Sh.P.K., gjithë kapacitetet e tij humane dhe teknike i ka vënë në dispozicion të përgatitjes për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit, ashtu që, anulimi i kësaj procedure të prokurimit,në mënyrë të kundërligjshme dhe pa arsye valide, atij i shkakton dëme të mëdha ekonomike, përkatësisht dëm në lartësi prej **EUR** 2,500.00 (**me fjalë:** dy mij e pesëqind Euro)

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të dosjës së tenderit;*

b) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve;*

c) *njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ndërmarrja Hidroekonomike "Thër Lepenc" SH.A;*

d) *aneksi 1;*

e) *njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – 5 tetor 2020.*

f) *kërkesa për rishqyrtim;*

g) *vendimi lidhur me kërkesën për shqyrtim.*